

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR

Drejtoria Rajonale Korçë

Nr. _____ Prot.

Korçë, më ____ / ____ / 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Zhvillimi i rjetit TU, TM ne agjensine Korçë dhe Pogradec

Loti 1: Kalimi i 4 fiderave të Gurit të Kuq nga 6 kV në 10 kV, Pogradec

Loti 2: Rrjet TU me kabell ABC Fshati Dishnicë, Fideri 21, Nënstacioni Korçë

Loti 3: Rrjet TU me kabell ABC Fshati Dvoran, fideri Fshat, Nënstacioni Gjanc Korçë

Loti 4: Rrjet TU me kabell ABC fshati Porodina, fideri 17, Nënstacioni Korçë

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Linja të energjisë elektrike 31321000-2

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fondi limit total:

122732211,34

(njqindenzetedymlioneshateqindetridhjetedyqindenzembetdhjetepresjetridhjetekater) leke pa TVSH

Loti 1: Kalimi i 4 fiderave të Gurit të Kuq nga 6 kV në 10 kV, Pogradec

Fondi limit: 31092782,95

(tridhjetenjemilioneentetdhjetedyqindetetdhjetepresjenentetdhjetepese) leke pa TVSH

Loti 2: Rrjet TU me kabell ABC Fshati Dishnicë, Fideri 21, Nënstacioni Korçë

Fondi limit: 29281523,23

(njetenentemiliondyqindetetedhjetenjemijepeseqindenjetetepresjenjetetetre)

Loti 3: Rrjet TU me kabëll ABC Fshati Dvoran, fideri Fshat, Nënstacioni Gjanc Korçë

Fondi limit: 41396108,91

(dyzetenjemilionetreqindenentedhjetegjashtemijenjeqindetetepresjenentedhjetenje) leke pa TVSH

Loti 4: Rrjet TU me kabëll ABC fshati Porodina, fideri 17, Nënstacioni Korçë

Fondi limit: 20961796,25

(njetemilionenenteqindegjashtedhjetenjemijeshtateqindnentedhjetegjashtepresjenjetetepese) leke pa TVSH

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) : REF-96472-08-18-2026

Loti 1 REF-96474-08-18-2026

Loti 2 REF-96481-08-18-2026

Loti 3 REF-96484-08-18-2026

Loti 4 REF-96486-08-18-2026

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Korce** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a. Korce ka vendosur që kjo procedure të jete ne lote sipas arsyetimit të mëposhtem:

Arsyeja pse është marrë vendim në lidhje me parashikimin e ndarjes në lote është bërë duke patur parasysh faktin, punimet që do të kryhen janë të ngjashme, me qëllim **rritjen e efikasitetit të zbatimit të kontratës, lehtësimin e menaxhimit të punimeve në terren**, si dhe **sigurimin e konkurrencës më të gjerë ndër operatorët ekonomikë**. Ndarja në lote lejon **monitorim më të detajuar të ecurisë së punimeve në secilën zonë dhe menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore dhe teknike** nga ana e autoritetit kontraktor.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën **1 (një)** nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore **mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.** Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar

*kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.***

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

*4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.***

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, dhe 2025 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të

njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilanci duhet të paraqitet nga secili anëtar.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetorë, për vitet financiare **2023, 2024**, dhe **2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilanci e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për vitin **2025**, për adresën ku ai ushtron aktivitetin sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislationit mjedisor, social dhe të punës

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

☐ Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

☐ punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kritereve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - ii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
 - iii. *Faturat Tatimore të deklaruara ne organet tatimore*
 - iv. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
 - v. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
 - vi. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
 - vii. *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*
- b) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:
- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
 - ii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
 - iii. *Faturat Tatimore të deklaruara ne organet tatimore*
 - iv. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
 - v. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shumica e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

- 2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
 - **Kategoria NP-1** (Punime gjurmimi në tokë) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-11** (Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) – **Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **Kategoria NS-1** (Punime për prishjen e ndërtimeve) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-8** (Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (Punime topogjeodezike) – **Klasifikimi A**

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentim:Keto liçenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt-preventiv. Kërkesa për keto liçenca profesionale është përcaktuar bazuar në nenin 77,të ligjit Nr.162 të datës 23.12.2020”Për Prokurimin publik”(I ndryshuar),neni 39,pika 6/a,të VKM nr.285 datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin Nr.162/2020”Për Prokurimin Publik”(I ndryshuar),në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285,datë:19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”si dhe VKM nr.42 datë: 16.01.2008”Për miratimin e klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.Të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e liçencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P1	Punime germimi ne toke	Germim gropash shtyllash	A	0-20 milion leke
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	F.V kabell ABC + aksesori F.V kabell koaksial + aksesori F.V kabell fuqie + aksesore Montim transformatore fuqie	A	0-20 milion leke
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje suvatim muri i brendshem, prishje shtresa betoni	A	0-20 milion lekë
N.S-8	Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri	Largimi i dherave dhe kthimi i sipërfaqes në gjendjen e mëparshme,	A	0-20 milion lekë
N.S -18	Punime topogjeodezike	FV vendosje shtylla te centrifuguara. (Piketim shtyllash)	A	0-20 milion leke

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 45001:2023** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 50001: 2018** (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i tyre të përputhet me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Lidhur me kriterin e kërkuar si me sipër, komisioni është bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020”Per prokurimin publik”neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021”Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ku nisur nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: *“Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”*

Komisioni vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimin e cilësisë së punimeve, i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

- **ISO 9001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- **ISO 14001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.
- **ISO 45001:2023**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- **ISO 50001: 2018**, është kërkuar me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës ndjek një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, në lidhje me zbatimin e kësaj qasje në pajisjet, sistemet, proceset dhe personelin që kontribuojnë në performancën e energjisë, gjë e cila i jep garancinë autoritetit kontraktor se veprimtaria e ofertuesit është në përputhje (konform) me politikën e performancës të shpallur të energjisë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dheu, shkulje shtyllash etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **22(njezetedy punonjës për muajin** e fundit te *deklaruar*, nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave*
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumn e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit, dhe afatit 3 mujor për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin zë, u llogarit shifra prej 22 punonjës.

Grupi i Projektimit ka analizuar zërat e preventivit duke nxjerrë orët e punës për secilin zë duke u konsultuar me sistemin SIM (e-albania).

Në total rezultuan 11955.6 orë pune. Këto orë pune u pjestuan 8 orë pune në dite dhe u pjestuan me 3 muaj (afati i realizimit), duke sjellë rezultatin prej 17 punonjësish + 5 punonjës stafi menaxherial (3 inxhinierët + administratori i shoqërisë + mjeku).

Këto dëshmi duhet të kërkohen për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me

anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësor. Për sa me siper, është e nevojshme që Operatorët ekonomikë të pasqyrojnë referencat të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndërtimit: është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave, të linjave TM/TU në objekt.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piketimin në lidhje me pozicionimin e shtyllave të linjave TM/TU në terren.
- Inxhinieri Elektrik: është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

b) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi 15 (pësemdhjetë) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Elektrici – jo më pak se **12 (dymbëdhjetë)** punonjës, ku jo më pak se **1 (një)** prej tyre të jetë i pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit Teknik dhe **1 (një)** me kategorinë V të Sigurimit Teknik.
- Murator- jo më pak se **1 (një)** punonjës

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme për periudhën e ekzekutimit të punës sipas grafikut të punimeve Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik, , lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, si dhe të gjithë punonjësit e kërkuar të figurojnë detyrimisht në listat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.7/b, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatoren e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentim: Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: Teknik ndërtimi, Elektriçist, Murator pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku ndër të tjerash, është kërkuar që të paraqesin certifikatat e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), ndërsa për teknikun duhet të paraqitet edhe diploma (dëftesat) përkatëse, me qëllim vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- c) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Argumentimi : Është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekësore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

Duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

- d) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhen e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dëshmi/ certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të licensuar/ akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm

për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar *nga data e hapjes së ofertave* punonjës të kualifikuar/çertifikuar si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) inxhinier** të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 237 date 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”*.
- Minimuni **1 (një) punonjës specialist** si **Ekspert zjarrrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 /dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 për :Miratimin e rregullores”Për sigurinë në Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarra, do të shmangë edhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do ti realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi

- e) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën **2 (dy)** punonjës të specializuar dhe çertifikuar për punime në lartësi, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për per **muajin** e fundit të deklaruar *nga data e hapjes së ofertave* ku për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme për periudhën e ekzekutimit të punës sipas grafikut të punimeve, dhe çertifikatat/ dëshmitë e trajnimit përkatëse lëshuar nga një organizëm i licencuar/çertifikuar.

Argumentimi: Njesia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) për vendosjen e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike në shtylla, si dhe

kemi punime në terrene me lartësi dhe pjerrësi të theksuar, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe pikës 13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve

- f) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë *(nga Administratori i shoqërisë)* Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, këto kërkesa, plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

- 2.3.7 a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi **1 (nje) manovratorë** (eskavatoriste/automakinist), te cilet duhet të jene te siguruar te pakten per muajin e fundit te deklaruar(nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratorët e pajisur me kartele personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohen nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi **te pakten 1 (nje) shofer**

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratë pune e vlefshme, Dëshmi Aftesie Profesionale te vlefshme (lëshuar nga institucionet perkatese), Librezë pune.

(Në rastin kur punonjësit /shofere janë të kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehesuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gërmimeve, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve manovratorë dhe shofere, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.8 (Makineri, Pajisje)

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	jo më pak se 1 copë
2.	Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton	jo më pak se 1 copë
3.	Mjet për riparim linja me kosh (me krah deri 25 m)	jo më pak se 1 copë
4.	Autovinç	jo më pak se 1 copë
5.	Ekskavator me goma	jo më pak se 1 copë
6.	Fadromë	jo më pak se 1 copë
7.	Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m ³ për punime në kantier	jo më pak se 1 copë
8.	Buldozer	jo më pak se 1 copë
9.	Vibrator betoni	jo më pak se 1 copë
10.	Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove	jo më pak se 3 copë
11.	Kit vegla pune	jo më pak se 10 copë
12.	Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale	jo më pak se 10 copë

13.	Pajisje tërheqëse për përcjellësa (deri 30 KN me lexim elektronik)	<i>jo më pak se 1 copë</i>
14.	Kenotron për kablllo	<i>jo më pak se 1 copë</i>
15.	Gjenerator për kantierin	<i>jo më pak se 1 copë</i>
16.	Pajisje tërheqëse për kablllo (me dinamometër)	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Autokulle për punimin në lartësi	<i>jo më pak se 1 copë</i>

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 17 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 4 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*
- Kullë ndricimi – *jo më pak se 1 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- Për pajisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 4- Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetohet se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.9/a, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatorën e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të punimeve që do të kryhen, nisur nga preventivi komisioni ka vlerësuar se mjetet e kërkuara janë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës si më poshtë:

- Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e shtyllave në objekt . Zëri në analizë: F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 10/15 m/kN, 220/370 d1/d2 (me makineri)
- Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton – është e nevojshme pasi shërben për ngritjen dhe montimin e transformatorëve të kabinave elektrike , dhe transportimin e e telit alumino-celik Zëri në analizë: Shtrirje e terheqje 3 fije teli (percjellesa) me makineri, alumin-celik, me seksion 50 m/m² ,Montim Transformatorë të fuqisë ÷ 560 kVA, 20/10/6/0.4 kV.
- Autovinç- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve te demontuara. Zëri në analizë :Drejtimit shtylla të centrifuguara betonarme (me makineri), Demontim ndarës i brendshëm 6/10/20 kV etj.
- Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m³ për punime në kantier – është e domosdoshme për punimet e betonit për bazamentet e shtyllave,kabinave,kanaleve të kabllave. Zëri në analizë: Struktura monolite betoni C 16/20.
- Vibrator – është e domosdoshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit për bazamentet që të mos krijohen boshllëqe. Zëri ne preventiv -Struktura monolite betoni C 16/20
- Eskavator me goma 0.25 m³ - është i nevojshëm për hapje kanalesh për kablllo,themele për shtylla,gropa për bazamente/për pastrim ose rrafshim terreni.Njëkohësisht shërben edhe për ngarkim+shkarkim të materialeve(zhavor,rërë,dhe).Zëri në analizë: Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV,~2.5 m, sip tabani 1.5m² , Struktura monolite betoni C 16/20, Shtrese rere etj.

- Buldozer – është parahikuar të përdoret si makineri ndihmëse gjatë procesit të shtrirjes dhe montimit të 3 fijeve të përcjellësit ALC (ACSR), për përgatitjen dhe sistemimin e aksesit përgjatë trasesë së linjës, lëvizjen dhe pozicionimin e materialeve ,sistemimin e terrenit dhe krijimin e kushteve të nevojshme për realizimin e procesit të shtrirjes së përcjellësve. Makineria kontribuon në sigurimin e vazhdimësisë së procesit dhe në eliminimin e pengesave përgjatë trasesë. Zeri në analize Shtrirje e terheqje 3 fije teli (përcjellësa) me makineri, alumin-celik, me seksion 50 m/m²
- Vinç kulle – është një pajisje ndihmëse që shërben për ngritjen e pajisjeve të rënda dhe montimin e çmontimin e pajisjeve ekzistuese që do të demontohen.Zëri në analizë: Vendosije traverse metalike me vinc kulle, Montim i shkarkuesit të jashtëm tip ventil TM 6/10/20 kV, Montim i ndarësit të jashtëm TM 6/10/20 kV
- Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove – një mjet mbajtës i domosdoshëm që mundëson shtrirjen e sigurt dhe të rregullt të kablllove nga barabani. Kjo sjell lehtësim në tërheqjen e kabllit nga barabani pa e dëmtuar atë, pasi barabani qëndron i ngritur dhe rrotullohet lirshëm mbi kambalec.
- Gjenerator për kantierin – nevojitet pasi shërben për furnizimin me energji të pajisjeve elektrike ose për testimet në terren të pajisjeve.
- Mjet për riparim linja me kosh (me krah deri 25 m)- shërben për ngritjen e punonjesve në lartësi, për kryerjen e punimeve të preventivit për zerrat si me poshte, F.V. Kapikorde tubolare AL me presim për përcjellës 95mm² , Punime izolimi në shtylla elektrike në linja TM 6/10 kV, me 3 izolatore etj
- Kit vegla pune - përdoren për montimin dhe çmontimin e pajisjeve elektrike, përpunimin dhe lidhjen e kablllove e përcësve, montimin e terminaleve dhe aksesoreve, shtrëngimin e lidhjeve mekanike dhe elektrike, si dhe për kryerjen e punimeve të ndryshme ndihmëse gjatë instalimit dhe rikonstruksionit, parashikohet për realizimin e proceseve të suvatimit, duke përfshirë përgatitjen e sipërfaqes, përgatitjen dhe aplikimin e llaçit, nivelimin, drejtimin, realizimin e qosheve dhe përfundimin e sipërfaqes së suvatuar Përdorimi i kompletit të veglave është i nevojshëm për realizimin e proceseve të punës në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike të punimeve .
- Minifadrome/Minidamper, shërbejnë për kryerjen e punimeve për zerrat Germim dheu për gropa shtyllash T/L, në toke të forta kat IV, ~2.5 m, sipërfaqe 1.5m²

- Instrument per piketim (GPS) , sherben per piketimin e shtyllave referuar zerave te punimeve An F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN,150/285 d1/d2 (me makineri), An F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/15 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)
- Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale- përdoret si pajisje ndihmëse e procesit të montimit të linjës ajrore, për mbështetjen dhe drejtimin e përcjellësve gjatë tërheqjes.
- Kenotron për kabllot – është i nevojshme pasi është një pajisje e cila teston izolimin e kabllave(kontroll i cilësisë para vendosjes së tij në objekt), zeri i punimeve Kenotronim i kokave te kabllit per seksion (25 ÷ 240) mm², tension 24 kV.
- Terameter- sherben per matjen e rezistences se tokezimit, zeri AN, 4.25 Matje kontroll i Rezistences se tokezimit per nje shtylle
- Pajisje tërheqëse për përcjellësa (deri 30 KN me lexim elektronik) përdoret për realizimin e drejtpërdrejtë të procesit të shtrirjes dhe tërheqjes së përcjellësve ALC/ACSR përgjatë trasesë së linjës ajrore. Pajisja mundëson tërheqjen e kontrolluar të përcjellësit nëpërmjet karrukullave udhëzuese, duke monitoruar forcën e aplikuar dhe duke parandaluar tejkalimin e parametrave të lejuar gjatë procesit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht

1.Analizat e çmimeve te zerave te preventivit jane marre ne baze VKM Nr. 629 date 15.07.2015

2 - Analiza e çmimeve te zerave qe nuk jane ne fletoren zyrtare jane bere ne baze te librit Nr.6 " Montimi i

linjave dhe nestacioneve elektrike" dhe te manualit "Preventivimi per rrjetat elektrike komunal" sipas

udhezimit Nr.2 date 08.05.2003 mbeshtetur ne VKM Nr.8402 date 10.09.1998

3 - Çmimet e baze materiale jane marre ne Drejtorine ekonomike te OSHEE (SAP - i) date 03.02.2015

4 - Volumet e germimeve, betonimeve dhe te montimeve jane marre sipas standarteve te OSHEE ,bashkengjitur projektit.

5 - Paga orare eshte marre mesatarja e nje punonjesi te OSHEE 185 leke

6 - Sigurimet shoqerore jane marre 16.7 % sipas VKM VKM Nr. 629 date 15.07.2015.

- 7 - Per pumimet e ndertimit e te montimit ne baze te udhezimit Nr. 2 te date 08.05.2003 te VKM Nr. 8402 date 10.09.1998 eshte marre shtesa 50 % mbi page.
- 8 - Shpenzimet plotesuese jane marre 5 % sipas VKM Nr. 629 date 15.07.2015.
- 9 - Norma e fitimit eshte marre 10 % sipas VKM Nr. 629 date 15.07.2015.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.*
- Leje Mjedisi nga QKL, (*përkatëse*) në përputhje me ligjin.

Në rastin kur Kantier për prodhimin e betonit nuk janë në pronësi apo me qera nga OE, por me kontratë furnizimi shmangen nga paraqitja e dokumentacionit me sipër.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Gjithashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantieri për prodhimin e betonit në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/produkteve, duke qënë se kemi të bëjmë me produkt i cili duhet të prodhohet nga prodhues të licencuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/ qera) kantierin, ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet kantierin për prodhimin e betonit, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e kantierit, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontrata e furnizimit është lidhur me një subjekt i cili e disponon këtë kantier. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se pala furnizuese është prodhuese e këtij malli.

2.3.10 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s’kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Loti 2: Rrjet TU me kabell ABC Fshati Dishnicë, Fideri 21, Nënstacioni Korçë

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.4 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën **1 (një)** nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore **mund të kërkojnë që operatorët**

ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.**

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin

mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, dhe 2025 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

- 2.2.5 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

- 2.2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për vitin **2025**, për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim: Ne lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislationit mjedisor, social dhe të punës

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.11 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- ☐ Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- ☐ punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

c) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- viii. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ix. Situacionin përfundimtar të objektit*
- x. Faturat Tatimore të deklaruara ne organet tatimore*
- xi. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- xii. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- xiii. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- xiv. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

d) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- vi. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- vii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- viii. Faturat Tatimore të deklaruara ne organet tatimore*
- ix. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- x. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.12 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
 - **Kategoria NP-1** (Punime gjurmimi në tokë) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-11** (Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) – **Klasifikimi A**

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **Kategoria NS-8** (*Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri*) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (*Punime topogjeodezike*) – **Klasifikimi A**

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentim: Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt-preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr.162 të datës 23.12.2020 "Për Prokurimin publik" (I ndryshuar), neni 39, pika 6/a, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (I ndryshuar), në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285, datë: 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik" si dhe VKM nr.42 datë: 16.01.2008 "Për miratimin e klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

N.P1	Punime germimi ne toke	Germim gropash shtyllash	A	0-20 milion leke
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	F.V kabell ABC + aksesori F.V kabell koaksial + aksesori F.V kabell fuqie + aksesore Montim transformatore fuqie	A	0-20 milion leke
N.S-8	Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri	Largimi i dherave dhe kthimi i sipërfaqes në gjendjen e mëparshme,	A	0-20 milion lekë
N.S -18	Punime topogjeodezike	FV vendosje shtylla te centrifuguara. (Piketim shtyllash)	A	0-20 milion leke

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 45001:2023** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 50001: 2018** (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i tyre të përputhet me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Lidhur me kriterin e kerkuar si me sipër, komisioni është bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020”Per prokurimin publik” neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021”Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ku nisur nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: “Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Komisioni vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimin e cilesise se punimeve,i lidhur ngushte me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

- **ISO 9001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- **ISO 14001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.
- **ISO 45001:2023**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- **ISO 50001: 2018**, është kërkuar me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës ndjek një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, në lidhje me zbatimin e kësaj qasje në pajisjet, sistemet, proceset dhe personelin që kontribuojnë në performancën e energjisë, gjë e cila i jep garancinë autoritetit kontraktor se veprimtaria e ofertuesit është në përputhje (konform) me politikën e performancës të shpallur të energjisë.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë liçencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dheu, shkulje shtyllash etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me

nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **40(dyzet) punonjës** për **muajin** e fundit te *deklaruar*, nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

3. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave*
4. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit, dhe afatit 3 mujor për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin zë, u llogarit shifra prej 40 punonjës.

Grupi i Projektimit ka analizuar zërat e preventivit duke nxjerrë orët e punës për secilin zë duke u konsultuar me sistemin SIM (e-albania).

Në total rezultuan 24861.24 orë pune. Këto orë pune u pjestuan 8 orë pune në dite dhe u pjestuan me 3 muaj (afati i realizimit), duke sjellë rezultatin prej 35 punonjësish + 5 punonjës stafi menaxherial (3 inxhinierët + administratori i shoqërisë + mjeku).

Këto dëshmi duhet të kërkohen për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojnë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

2.3.16 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Elektrik**
- Minimuni 1 (një) **Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas një standarti të përshtatshëm cilësor. Për sa me siper, është e nevojshme që Operatorët ekonomikë të pasqyrojnë referencat të përshtatshme nga kontratat të zbatuara në të shkuarën nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndertimit: është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave, të linjave TM/TU në objekt.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piketime në lidhje me pozicionimin e shtyllave të linjave TM/TU në terren.
- Inxhinieri Elektrik: është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

g) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi 29(njezetenente) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **27(njezeteshtate)** punonjës, ku jo më pak se **1 (nje)** prej tyre të jetë i pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit Teknik dhe **1 (një)** me kategorinë V të Sigurimit Teknik.

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: : kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme për periudhën e ekzekutimit të punës sipas grafikut të punimeve Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik, , lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, si dhe të gjithë punonjësit e kërkuar të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.7/b, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatoren e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentim: Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: *Teknik ndërtimi, Elektriçist, Murator* pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku ndër të tjerash, është kërkuar që të paraqesin certifikatat e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), ndërsa për teknikun duhet të paraqitet edhe diploma (dëftesat) përkatëse, me qëllim vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate,

dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- h)** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Argumentimi : Është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekësore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

Duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

- i)** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhën e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dëshmi/çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të licensuar/ akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave* punonjës të kualifikuar/çertifikuar si më poshtë:
- Minimuni **1 (një) inxhinier** të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
 - Minimuni **1 (një) punonjës specialist** si **Ekspert zjarrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 /dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 për :Miratimin e rregullores”Për sigurinë në Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarrë, do të shmangë edhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do ti realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi

- j) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 2 (dy) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për punime në lartësi, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave* ku për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhen e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dhe çertifikatat/ dëshmitë e trajnimit përkatëse lëshuar nga një organizëm i licencuar/çertifikuar.

Argumentimi: Njesia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) për vendosjen e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike në shtylla, si dhe kemi punime në terrene me lartësi dhe pjerrësi të theksuar, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe pikës 13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve

- k) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë,

dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, këto kërkesa, plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

- 2.3.17a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi 3 (tre) **manovratorë** (eskavatoriste/automakinist), te cilet duhet të jenë të siguruar të pakten për muajin e fundit të deklaruar (nese automjetet janë në pronësi të OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratorët e pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, mund të kontraktohen nga OE ofertues për realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi të pakten 3 (tre) shofere

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratë pune e vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale të vlefshme (lëshuar nga institucionet perkatese), Librezë pune.

(Në rastin kur punonjësit /shofere janë të kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehesuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gërmimeve, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve manovratorë dhe shofere, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.18 (Makineri, Pajisje)

- c) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
2.	Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
3.	Mjet për riparim linja me kosh (<i>me krah deri 25 m</i>)	<i>jo më pak se 1 copë</i>
4.	Autovinç	<i>jo më pak se 1 copë</i>
5.	Ekskavator me goma	<i>jo më pak se 1 copë</i>
6.	Minifadrome/Minidamper	<i>jo më pak se 1 copë</i>
7.	Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m ³ për punime në kantier	<i>jo më pak se 1 copë</i>
8.	Vibrator betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
9.	Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove	<i>jo më pak se 3 copë</i>
10.	Kit vegla pune	<i>jo më pak se 10 copë</i>
11.	Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale	<i>jo më pak se 10 copë</i>
12.	Pajisje tërheqëse për kablllo me dinamometër	<i>jo më pak se 1 copë</i>
13.	Kenotron për kablllo	<i>jo më pak se 1 copë</i>
14.	Gjenerator për kantierin	<i>jo më pak se 1 copë</i>
15.	Terameter	<i>jo më pak se 1 copë</i>
16.	Vinc kulle	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Instrument për piketim (GPS)	<i>jo më pak se 1 copë</i>

- d) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 17 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 4 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*
- Kullë ndricimi – *jo më pak se 1 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*

❑ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 5- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 6- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 7- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 8- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.9/a, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatoren e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të punimeve që do të kryhen, nisur nga preventivi komisioni ka vlerësuar se mjetet e kërkuara janë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës si më poshtë:

- Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e shtyllave në objekt . Zëri në analizë: F.V. Shtylla të centrifuguara B/A cent.9/6 m/kN,150/255 d1/d2 (me makineri), F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)
- Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton – është e nevojshme pasi shërben për transportimin e e kabllit ABC Zëri në analizë: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm²
- Autovinç- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve te demontuara. Zëri në analizë : Demontim Shtylla druri (me makineri) ,Demontim traverse te vogla me krah. etj.
- Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m³ për punime në kantier – është e domosdoshme për punimet e betonit për bazamentet e shtyllave. Zëri në analizë: Struktura monolite betoni C 16/20.
- Vibrator – është e domosdoshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit për bazamentet që të mos krijohen boshllëqe. Zeri ne preventiv -Struktura monolite betoni C 16/20
- Eskavator me goma 0.25 m³ - është i nevojshëm për hapje,themele për shtylla,gropa për bazamente/për pastrim ose rrafshim terreni.Njëkohësisht shërben edhe për ngarkim+shkarkim të materialeve(zhavor,rërë,dhe).Zëri në analizë: Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV,~2.5 m, sip tabani 1.5m² , Struktura monolite betoni C 16/20, Shtrese rere etj.
- Vinç kulle – është një pajisje ndihmëse që shërben për ngritjen dhe vendosjen e percejllesi ABC dhe terminaleve .Zëri në analizë: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje

në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm², FV. Terminal TU 0.6/1kV në shtyllë për kalim nga kablli PVC në kabëll ABC(S=25÷120) mm².

- Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove – një mjet mbajtës i domosdoshëm që mundëson shtrirjen e sigurt dhe të rregullt të kablllove nga barabani. Kjo sjell lehtësim në tërheqjen e kabllit nga barabani pa e dëmtuar atë, pasi barabani qëndron i ngritur dhe rrotullohet lirshëm mbi kambalec.
- Gjenerator për kantierin – nevojitet pasi shërben për furnizimin me energji të pajisjeve elektrike ose për testimet në terren të pajisjeve.
- Mjet për riparim linja me kosh (me krah deri 25 m)- shërben për ngritjen e punonjesve në lartësi, për kryerjen e punimeve të preventivit .
- Kit vegla pune -nevojiten për montimin, përpunimin dhe lidhjen e kablllove e përçuesve, montimin e terminaleve dhe aksesorëve, shtrëngimin e lidhjeve mekanike dhe elektrike, si dhe për kryerjen e punimeve të ndryshme ndihmëse gjatë instalimit dhe rikonstruksionit.
- Minifadrome/Minidamper, shërbejnë për kryerjen e punimeve për zerat Germim dheu për gropat shtyllash T/L, në toke të forta kat IV, ~2.5 m, sipër tabani 1.5m²
- Instrument për piketim (GPS) , shërben për piketimin e shtyllave referuar zerave të punimeve An F.V. Shtylla të centrifuguara B/A cent.9/6 m/kN, 150/255 d1/d2 (me makineri), F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)
- Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale- përdoret si pajisje ndihmëse e procesit të montimit të linjës ajrore, për mbështetjen dhe drejtimin e përcjellësve gjatë tërheqjes.
- Kenotron për kabllot – është i nevojshme pasi është një pajisje e cila teston izolimin e kablllove (kontroll i cilësisë para vendosjes së tij në objekt), zeri i punimeve Kenotronim i kokave të kabllit për seksion (25 ÷ 240) mm², tension 24 kV.
- Terameter- shërben për matjen e rezistencës së tokezimit, zeri AN, 4.25 Matje kontroll i Rezistencës së tokezimit për një shtyllë
- Pajisje tërheqëse për kabllot me dinamometër – është e nevojshme pasi shërben për tërheqjen dhe tirimin e kabllit me vetëmbajtje ABC, që më pas fiksohet në tirantues dhe në këtë mënyrë

nuk dëmtohet izolimi i tij. Zëri i analizës: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm², F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm², F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm², F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm²,

2.3.19 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.*
- Leje Mjedisi nga QKL, (*përkatëse*) në përputhje me ligjin.

Në rastin kur Kantier për prodhimin e betonit nuk janë në pronësi apo me qera nga OE, por me kontratë furnizimi shmangen nga paraqitja e dokumentacionit me sipër.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që

ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Gjithashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantieri për prodhimin e betonit në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve, duke qënë se kemi të bëjmë me produkt i cili duhet të prodhohet nga prodhues të licencuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/ qera) kantierin, ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet kantierin për prodhimin e betonit, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e kantierit, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontrata e furnizimit është lidhur me një subjekt i cili e disponon këtë kantier. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se pala furnizuese është prodhuese e këtij malli.

2.3.20 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Shënim:

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen. Përjashtim bën vetëm Katalogu për materialet e kërkuar, i cili mund të jetë dhe në gjuhën Angleze.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Loti 3: Rrjet TU me kabëll ABC Fshati Dvoran, fideri Fshat, Nënstacioni Gjanc Korçë

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.7 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën **1 (një)** nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore**

minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore **mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.** Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitet dhe pasivitet. **Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.**

Nëse kërkohen bilance të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.”

Ndërsa në **nenin 88** “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera

tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, dhe 2025 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilancet duhet të paraqiten nga secili anëtar.

- 2.2.8 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

- 2.2.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për vitin **2025**, për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim: Ne lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.21 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- ☐ Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

- ☐ punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

e) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- xv. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- xvi. *Situacionin përfundimtar të objektit*
- xvii. *Faturat Tatimore të deklaruara ne organet tatimore*
- xviii. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
- xix. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- xx. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- xxi. *Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

f) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- xi. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- xii. *Situacionin përfundimtar të objektit*
- xiii. *Faturat Tatimore të deklaruara ne organet tatimore*
- xiv. *Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- xv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.22 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
 - **Kategoria NP-1** (Punime gjurmimi në tokë) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-11** (Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) – **Klasifikimi A**

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**

- **Kategoria NS-8** (Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri) – **Klasifikimi A**
- **Kategoria NS-18** (Punime topogjeodezike) – **Klasifikimi A**

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentim: Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt-preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr.162 të datës 23.12.2020 "Për Prokurimin publik" (I ndryshuar), neni 39, pika 6/a, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" (I ndryshuar), në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285, datë: 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik" si dhe VKM nr.42 datë: 16.01.2008 "Për miratimin e klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse

N.P1	Punime germimi ne toke	Germim gropash shtyllash	A	0-20 milion leke
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	F.V kabell ABC + aksesori F.V kabell koaksial + aksesori F.V kabell fuqie + aksesore Montim transformatore fuqie	A	0-20 milion leke
N.S-8	Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri	Largimi i dherave dhe kthimi i sipërfaqes në gjendjen e mëparshme,	A	0-20 milion lekë
N.S -18	Punime topogjeodezike	FV vendosje shtylla te centrifuguara. (Piketim shtyllash)	A	0-20 milion leke

2.3.23 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 45001:2023** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 50001: 2018** (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i tyre të përputhet me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Lidhur me kriterin e kerkuar si me sipër, komisioni është bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020”Per prokurimin publik” neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021”Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ku nisur nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: “Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Komisioni vendosi të kërkojë certifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimin e cilesise se punimeve,i lidhur ngushte me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

- **ISO 9001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- **ISO 14001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.
- **ISO 45001:2023**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- **ISO 50001: 2018**, është kërkuar me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës ndjek një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, në lidhje me zbatimin e kësaj qasje në pajisjet, sistemet, proceset dhe personelin që kontribuojnë në performancën e energjisë, gjë e cila i jep garancinë autoritetit kontraktor se veprimtaria e ofertuesit është në përputhje (konform) me politikën e performancës të shpallur të energjisë.

2.3.24 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë liçencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dheu, shkulje shtyllash etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me

nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta

2.3.25 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **52(pesedhjetedy) punonjës** për **muajin** e fundit te *deklaruar*, nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

5. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave*
6. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit, dhe afatit 3 mujor për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin zë, u llogarit shifra prej 52 punonjës.

Grupi i Projektimit ka analizuar zërat e preventivit duke nxjerrë orët e punës për secilin zë duke u konsultuar me sistemin SIM (e-albania).

Në total rezultuan 34056.28 orë pune. Këto orë pune u pjestuan 8 orë pune në dite dhe u pjestuan me 3 muaj (afati i realizimit), duke sjellë rezultatin prej 47 punonjësish + 5 punonjës stafi menaxherial (3 inxhinierët + administratori i shoqërisë + mjeku).

Këto dëshmi duhet të kërkohen për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojnë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

2.3.26 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar *nga data e hapjes së ofertave* stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas nje standarti të pershtatshem cilesie.Per sa me siper,eshte e nevojshme qe Operatoret ekonomike te pasqyrojne referenca te pershtatshme nga kontratatata te zbatuara ne te shkuaren nga ana e tyre.

- Inxhinieri i Ndertimit: eshte pergjegjes per punimet qe kane te bejne me betonimet e shtyllave, te linjave TM/TU ne objekt.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik: është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike qe kane te bejne me: piketime ne lidhje me pozicionimin e shtyllave te linjave TM/TU ne terren.
- Inxhinieri Elektrik: eshte pergjegjes per zbatimin e projektit te miratuar, sipas kushteve teknike per punime ne linja dhe kabina elektrike percaktuar sipas Rregullores se Shfrytezimit dhe Sigurimit teknik.

I) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi 41(dyzetenje) punonjës të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **39(tridhjetenente)** punonjës, ku jo më pak se **1 (nje)** prej tyre të jetë i pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit Teknik dhe **1 (një)** me kategorinë V të Sigurimit Teknik.

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin : kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhen e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik, , lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, si dhe të gjithë punonjësit e kërkuar të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.7/b, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatoren e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentim: Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: *Teknik ndërtimi, Elektriçist, Murator* pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku ndër të tjerash, është kërkuar që të paraqesin certifikatat e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), ndërsa për teknikun duhet të paraqitet edhe diploma (dëftesat) përkatëse, me qëllim vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate,

dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike**, si dhe të figurojnë të punësuar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

- m)** Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Argumentimi : Është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekësore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

Duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

- n)** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhën e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dëshmi/çertifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të licensuar/ akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listëpagesat e shoqërisë per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave* punonjës të kualifikuar/çertifikuar si më poshtë:
- Minimuni **1 (një) inxhinier** të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
 - Minimuni **1 (një) punonjës** specialist si **Ekspert zjarrëfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të çertifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 /dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 për :Miratimin e rregullores”Për sigurinë në Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarrë, do të shmangë edhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do ti realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi

- o) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 2 (dy) punonjës të specializuar dhe çertifikuar për punime në lartësi, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave* ku për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhen e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dhe çertifikatat/ dëshmitë e trajnimit përkatëse lëshuar nga një organizëm i licencuar/çertifikuar.

Argumentimi: Njesia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) për vendosjen e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike në shtylla, si dhe kemi punime në terrene me lartësi dhe pjerrësi të theksuar, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe pikës 13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve

- p) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë,

dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, këto kërkesa, plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

- 2.3.27 a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi 3 (tre) **manovratorë** (eskavatoriste/automakinist), te cilet duhet të jenë të siguruar të pakten për muajin e fundit të deklaruar (nese automjetet janë në pronësi të OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratorët e pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, mund të kontraktohen nga OE ofertues për realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi te pakten 3 (tre) shofere

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratë pune e vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale të vlefshme (lëshuar nga institucionet perkatese), Librezë pune.

(Në rastin kur punonjësit /shofere janë të kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehesuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gërmimeve, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve manovratorë dhe shofere, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t'u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.28 (Makineri, Pajisje)

- e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
2.	Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
3.	Mjet për riparim linja me kosh (<i>me krah deri 25 m</i>)	<i>jo më pak se 1 copë</i>
4.	Autovinç	<i>jo më pak se 1 copë</i>
5.	Ekskavator me goma	<i>jo më pak se 1 copë</i>
6.	Minifadrome/Minidamper	<i>jo më pak se 1 copë</i>
7.	Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m ³ për punime në kantier	<i>jo më pak se 1 copë</i>
8.	Vibrator betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
9.	Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove	<i>jo më pak se 3 copë</i>
10.	Kit vegla pune	<i>jo më pak se 10 copë</i>
11.	Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale	<i>jo më pak se 10 copë</i>
12.	Pajisje tërheqëse për kablllo me dinamometër	<i>jo më pak se 1 copë</i>
13.	Kenotron për kablllo	<i>jo më pak se 1 copë</i>
14.	Gjenerator për kantierin	<i>jo më pak se 1 copë</i>
15.	Terameter	<i>jo më pak se 1 copë</i>
16.	Vinc kulle	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Instrument për piketim (GPS)	<i>jo më pak se 1 copë</i>

- f) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 17 copë*
- Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 4 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*
- Kullë ndricimi – *jo më pak se 1 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*

❑ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 9- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 10- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 11- Për paisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 12- Për paisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.9/a, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatorën e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të punimeve që do të kryhen, nisur nga preventivi komisioni ka vlerësuar se mjetet e kërkuara janë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës si më poshtë:

- Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e shtyllave në objekt . Zëri në analizë: F.V. Shtylla të centrifuguara B/A cent.9/6 m/kN,150/255 d1/d2 (me makineri), F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)
- Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton – është e nevojshme pasi shërben për transportimin e e kabllit ABC Zëri në analizë: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm²
- Autovinç- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve te demontuara. Zëri në analizë : Demontim Shtylla druri (me makineri) ,Demontim traverse te vogla me krah. etj.
- Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m³ për punime në kantier – është e domosdoshme për punimet e betonit për bazamentet e shtyllave. Zëri në analizë: Struktura monolite betoni C 16/20.
- Vibrator – është e domosdoshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit për bazamentet që të mos krijohen boshllëqe. Zeri ne preventiv -Struktura monolite betoni C 16/20
- Eskavator me goma 0.25 m³ - është i nevojshëm për hapje,themele për shtylla,gropa për bazamente/për pastrim ose rrafshim terreni.Njëkohësisht shërben edhe për ngarkim+shkarkim të materialeve(zhavor,rërë,dhe).Zëri në analizë: Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV,~2.5 m, sip tabani 1.5m² , Struktura monolite betoni C 16/20, Shtrese rere etj.
- Vinç kulle – është një pajisje ndihmëse që shërben për ngritjen dhe vendosjen e percejllesi ABC dhe terminaleve .Zëri në analizë: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje

në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm², FV. Terminal TU 0.6/1kV në shtyllë për kalim nga kabli PVC në kabël ABC(S=25÷120) mm².

- Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kabllave – një mjet mbajtës i domosdoshëm që mundëson shtrirjen e sigurt dhe të rregullt të kabllave nga barabani. Kjo sjell lehtësim në tërheqjen e kabllit nga barabani pa e dëmtuar atë, pasi barabani qëndron i ngritur dhe rrotullohet lirshëm mbi kambalec.
- Gjenerator për kantierin – nevojitet pasi shërben për furnizimin me energji të pajisjeve elektrike ose për testimet në terren të pajisjeve.
- Mjet për riparim linja me kosh (me krah deri 25 m)- shërben për ngritjen e punonjesve në lartësi, për kryerjen e punimeve të preventivit .
- Kit vegla pune -nevojiten për montimin, përpunimin dhe lidhjen e kabllave e përçuesve, montimin e terminaleve dhe aksesorëve, shtrëngimin e lidhjeve mekanike dhe elektrike, si dhe për kryerjen e punimeve të ndryshme ndihmëse gjatë instalimit dhe rikonstruksionit.
- Minifadrome/Minidamper, shërbejnë për kryerjen e punimeve për zerrat Germim dheu për gropat shtyllash T/L, në toke të forta kat IV, ~2.5 m, sipër tabani 1.5m²
- Instrument për piketim (GPS) , shërben për piketimin e shtyllave referuar zerave të punimeve An F.V. Shtylla të centrifuguara B/A cent.9/6 m/kN, 150/255 d1/d2 (me makineri), F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)
- Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale- përdoret si pajisje ndihmëse e procesit të montimit të linjës ajrore, për mbështetjen dhe drejtimin e përcjellësve gjatë tërheqjes.
- Kenotron për kabllot – është i nevojshëm pasi është një pajisje e cila teston izolimin e kabllave (kontroll i cilësisë para vendosjes së tij në objekt), zeri i punimeve Kenotronim i kokave të kabllit për seksion (25 ÷ 240) mm², tension 24 kV.
- Terameter- shërben për matjen e rezistencës së tokezimit, zeri AN, 4.25 Matje kontroll i Rezistencës së tokezimit për një shtyllë
- Pajisje tërheqëse për kabllot me dinamometër – është e nevojshme pasi shërben për tërheqjen dhe tirimin e kabllit me vetëmbajtje ABC, që më pas fiksohet në tirantues dhe në këtë mënyrë

nuk dëmtohet izolimi i tij. Zëri i analizës: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm², F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm², F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm², F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm²,

2.3.29 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Noteriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.*
- Leje Mjedisi nga QKL, (*përkatëse*) në përputhje me ligjin.

Në rastin kur Kantier për prodhimin e betonit nuk janë në pronësi apo me qera nga OE, por me kontratë furnizimi shmangen nga paraqitja e dokumentacionit me sipër.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që

ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Gjithashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantieri për prodhimin e betonit në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve, duke qënë se kemi të bëjmë me produkt i cili duhet të prodhohet nga prodhues të licencuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/ qera) kantierin, ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet kantierin për prodhimin e betonit, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e kantierit, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontrata e furnizimit është lidhur me një subjekt i cili e disponon këtë kantier. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se pala furnizuese është prodhuese e këtij malli.

Loti 4: Rrjet TU me kabëll ABC fshati Porodina, fideri 17, Nënstacioni Korçë

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.10 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën **1 (një)** nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 100 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shumta e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar), në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.** Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore **mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.** Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”

Në **nenin 43** “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko - financiare” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, **kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.**”

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. **Nëse kërkojnë një ose dy bilanci, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilanci/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Nëse kërkojnë bilanci të tri viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Ndërsa në **nenin 88** “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**”*

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se:

Referuar ligjit nr.25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “*Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, dhe 2025 lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më pak se 100 % e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet, dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2023, 2024, 2025) të konfirmuar nga administrata tatimore, pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilanci kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilanci të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021, vlera e xhiros duhet të përmbushet në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, ndërsa bilanci duhet të paraqitet nga secili anëtar.

2.2.11 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të

shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

2.2.12 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat vendore për vitin **2025**, për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentim: Ne lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislationit mjedisor, social dhe të punës

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.30 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

☐ Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

☐ punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

g) Në rast se punimet janë kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- xxii. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- xxiii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- xxiv. Faturat Tatimore te deklaruara ne organet tatimore*
- xxv. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- xxvi. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- xxvii. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- xxviii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

h) Në rast se punimet janë kryer **në sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- xvi. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- xvii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- xviii. Faturat Tatimore te deklaruara ne organet tatimore*
- xix. Çertifikatë e marrjes në dorëzim të objektit*
- xx. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të loteve për të cilat OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoje duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën

me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.31 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
 - **Kategoria NP-1** (Punime gërmimi në tokë) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NP-11** (Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) – **Klasifikimi A**
- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:**
 - **Kategoria NS-8** (Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri) – **Klasifikimi A**
 - **Kategoria NS-18** (Punime topogjeodezike) – **Klasifikimi A**

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t’i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentim:Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt-preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është përcaktuar bazuar në nenin 77,të ligjit Nr.162 të datës 23.12.2020”Për Prokurimin publik”(I ndryshuar),neni 39,pika 6/a,të VKM nr.285

datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin Nr.162/2020”Për Prokurimin Publik”(I ndryshuar),në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.285,datë:19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të prokurimit Publik”si dhe VKM nr.42 datë: 16.01.2008”Për miratimin e klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi.Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P1	Punime germimi ne toke	Germim gropash shtyllash	A	0-20 milion leke
N.P11	Ndertime per N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e te mesme dhe shperndarje e energjise	F.V kabell ABC + aksesor F.V kabell koaksial + aksesor F.V kabell fuqie + aksesore Montim transformatore fuqie	A	0-20 milion leke
N.S-8	Ndërtime parafabrikat me beton arme, struktura metalike dhe druri	Largimi i dherave dhe kthimi i sipërfaqes në gjendjen e mëparshme,	A	0-20 milion lekë

N.S -18	Punime topogjeodezike	FV vendosje shtylla te centrifuguara. (Piketim shtyllash)	A	0-20 milion leke
---------	-----------------------	---	---	------------------

2.3.32 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të cilësisë) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** (Për sistemin e menaxhimit të mjedisit) e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 45001:2023** (Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar
- Çertifikatë **ISO 50001: 2018** (Për sistemin e menaxhimit të energjisë) ose ekuivalente me të, të njohur nga Standartet Shqipëtare, e përditësuar

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe objekti i tyre të përputhet me objektin e prokurimit. Nëse çertifikatat janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me përkthimin në gjuhën shqipe të noterizuar. Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Lidhur me kriterin e kerkuar si me sipër, komisioni është bazuar referuar Ligjit Nr.162 date:23.12.2020”Per prokurimin publik”neni 77,dhe neni 44,pika 1 te VKM nr.285,date 19.05.2021”Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ku nisur nga percaktimi I kerkesave per kualifikim per Operatorin Ekonomik bazuar ne aftesite teknike dhe profesionale citon se: “Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Komisioni vendosi të kërkojë çertifikatat e mësipërme për të vërtetuar që Operatori Ekonomik disponon licensat mbi menaxhimin e cilësisë së punimeve, i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

- **ISO 9001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e efektivitetit dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së operatorit ekonomik, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove, duke bërë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- **ISO 14001:2015**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim

do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **ISO 45001:2023**, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgaditjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
- **ISO 50001: 2018**, është kërkuar me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës ndjek një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, në lidhje me zbatimin e kësaj qasje në pajisjet, sistemet, proceset dhe personelin që kontribuojnë në performancën e energjisë, gjë e cila i jep garancinë autoritetit kontraktor se veprimtaria e ofertuesit është në përputhje (konform) me politikën e performancës të shpallur të energjisë.

2.3.33 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë licencën – Kodi III.2.B - “Për grumbullim dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), të vlefshme.

Argumentimi: Referuar preventivit të punimeve, duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dheu, shkulje shtyllash etj., dhe kryerjen e transportit të tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta

2.3.34 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se 29(njezetenente) **punonjës për muajin** e fundit të deklaruar, nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës

duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për **muajin** e fundit të deklaruar *nga data e hapjes së ofertave*

Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për per **muajin** e fundit të deklaruar *nga data e hapjes së ofertave*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

- Numri i fuqisë punëtore u llogarit duke u bazuar në volumin e punimeve që duhen kryer sipas projekt-preventivit, dhe afatit 3 mujor për kryerjen e punimeve. Në bazë të orëve të punës të marra nga analizat për secilin zë, u llogarit shifra prej 29 punonjës.

Grupi i Projektimit ka analizuar zërat e preventivit duke nxjerrë orët e punës për secilin zë duke u konsultuar me sistemin SIM (e-albania).

Në total rezultuan 17315.83orë pune. Këto orë pune u pjestuan 8 orë pune në dite dhe u pjestuan me 3 muaj (afati i realizimit), duke sjellë rezultatin prej 24 punonjësish + 5 punonjës stafi menaxherial (3 inxhinierët + administratori i shoqërisë + mjeku).

Këto dëshmi duhet të kërkohen për shkak të natyrës së punimeve, punonjësit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë nëpër caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.

2.3.35 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, libreze pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave* stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (nje) Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas nje standarti te pershtatshem cilesie.Per sa me siper,eshte e nevojshme qe Operatoret ekonomike te pasqyrojne referenca te pershtatshme nga kontratat te zbatuara ne te shkuaren nga ana e tyre.

- **Inxhinieri i Ndërtimit:** është përgjegjës për punimet që kanë të bëjnë me betonimet e shtyllave,te linjave TM/TU ne objekt.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik:** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike që kanë të bëjnë me: piktetime ne lidhje me pozicionimin e shtyllave te linjave TM/TU ne terren.
- **Inxhinieri Elektrik:** është përgjegjës për zbatimin e projektit të miratuar, sipas kushteve teknike për punime në linja dhe kabina elektrike përcaktuar sipas Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik.

- q) Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë minimumi **20(njezet) punonjës** të specializuar/ kualifikuar si më poshtë:

- Teknik ndërtimi – jo më pak se **1 (nje)** punonjës
- Elektriçist – jo më pak se **19(nentembedhjte)** punonjës, ku jo më pak se **1 (nje)** prej tyre të jetë i pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit Teknik dhe **1 (një)** me kategorinë V të Sigurimit Teknik.

* Për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit sipas specialitetit të kërkuar, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: : kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme për periudhën e ekzekutimit të punës sipas grafikut të punimeve Kartelat përkatëse të Sigurimit Teknik, , lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*” ose ekuivalente, si dhe të gjithë punonjësit e kërkuar të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.7/b, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatorën e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentim: Referuar natyrës, dhe përmasave/ volumit të punimeve që përmban objekti i prokurimit, **me qëllim vërtetimin e aftësisë zbatuese të kontratës**, njësia e prokurimit vlerëson se, operatorët ekonomik duhet të disponojnë stafin mbështetës të kualifikuar për kryerjen e të gjitha punimeve objekt prokurimi, të cilët duhet të jenë me specialitetin: *Teknik ndërtimi, Elektriçist, Murator* pasi pa këto punonjës nuk mund të kryhen/ realizohen punimet objekt kontrate prokurimi, ku ndër të tjerash, është kërkuar që të paraqesin certifikatat e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), ndërsa për teknikun duhet të paraqitet edhe diploma (dëftesat) përkatëse, me qëllim vërtetimin se këto punonjës janë të kualifikuar për kryerjen e punimeve objekt kontrate, dhe kanë njohuri për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në punë në lidhje kryerjen e punimeve, përdorimin e mjeteve, marrjen e masave mbrojtëse etj., **në zbatim të Rregullores së Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike**, si dhe të figurojnë të punësuar në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar.

r) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, duhet

të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Argumentimi : Është bazuar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, sipas të cilave, kompanitë që operojnë në fushën e ndërtimit, mund të sigurojnë shërbimet mjekesore për stafin e tyre, nëpërmjetë punesimit të një mjeku, apo nëpërmjet marrëdhënieve kontraktore me individë apo subjekte që operojnë që në këtë fushë.

Duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e prokurimit vlerëson se, kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

- s) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhen e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dëshmi/ certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të licensuar/ akredituar sipas ligjit, diplomat (vetëm për punonjësit inxhinierë të kërkuar), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë per **muajin** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave punonjës të kualifikuar/ certifikuar si më poshtë:
- Minimuni **1 (një) inxhinier** të disponojë certifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
 - Minimuni **1 (një) punonjës specialist** si **Ekspert zjarrefiks** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, të certifikuar nga Drejtoria e MZSH-së.

Disponimi i stafit mbështetës do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Argumentimi: Në bazë të VKM nr. 108, datë 9.2.2011, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në dispozitën III-pika 10.5 / 10.12 / 10.13 /dispozita IV-pika 7-a,b,b1,b2,b3,c1-shprehet qartësisht aftësitë që duhet të ketë punonjësi i ngarkuar për menaxhimin e riskut I cili duhet të plotësojë kushtet në lidhje me çështjet e sigurisë në punë.

Gjithashtu në përputhje me klauzolat e ligjit Nr.10327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe VKM Nr.312 Dt: 5.5.2010 për :Miratimin e rregullores”Për sigurinë në Kantier”.

Vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që operatori ekonomik ,në këtë mënyrë lidhur me masat tekniko-organizative që do të ndërmarrë, do të shmangë edhe rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë zbatimit të punimeve dhe do ti realizojë ato sipas standarteve ligjore në fuqi

- t) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij, të paktën 2 (dy) punonjës të specializuar dhe certifikuar për punime në lartësi, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për per **muajin** e fundit te deklaruar *nga data e hapjes se ofertave* ku për përmbushjen e kësaj pikë operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë punonjësit në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për secilin punonjës, duhet të paraqesë dokumentacionin: kontrata e punës e vlefshme ose kontrata e punës e vlefshme per periudhen e ekzekutimit te punes sipas grafikut te punimeve, dhe certifikatat/ dëshmitë e trajnimit përkatëse lëshuar nga një organizëm i licencuar/certifikuar.

Argumentimi: Njesia e prokurimit vlerëson se kjo kërkesë është e domosdoshme, duke qënë se bazuar në preventivin e punimeve kemi të bëjmë me kryerje të punimeve në lartësi (mbi 2 m) për vendosjen e linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike në shtylla, si dhe kemi punime në terrene me lartësi dhe pjerrësi të theksuar, kërkesë kjo në zbatim të përcaktimeve të nenit 11 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe pikës 13 të Aneksit V/ Seksioni II/ Pjesa B e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores “Për Sigurinë në Kantier”, ku për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të paraqesë kontratat e punës (të vlefshme), dhe Çertifikatat përkatëse të punonjësve që do të angazhojë për kryerjen e këtyre punimeve

- u) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate *(nga Administratori i shoqërisë)* Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, *ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, këto kërkesa, plotësohen nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

2.3.36a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi 2 (dy) **manovratorë** (eskavatoriste/automaknist), te cilet duhet të jene te siguruar te pakten per muajin e fundit te deklaruar(nese automjetet jane ne pronesi te OE ofertues).

Ne rastin kur automjetet merren me qira, manovratorët e pajisur me karte personale te sigurimit teknik, mund te kontraktohen nga OE ofertues per realizimin e kontrates objekt procedure prokurimi dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi nga organet përkatëse sipas ligjit,
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar, minimumi te pakten 2 (dy) shofere

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratë pune e vlefshme, Dëshmi Aftësie Profesionale të vlefshme (leshuar nga institucionet perkatese), Librezë pune.

(Në rastin kur punonjësit /shofere janë të kontraktuar me kontratë pune/sherbimi (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë)

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehesuara me origjinalin.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferët duhet të disponojnë dëshmitë e nevojshme për drejtimin e mjeteve të rënda të kërkuara, me qëllim kryerjen e punimeve të gërmimeve, pasi pa këto mjete nuk mund të kryhen punimet objekt kontrate. Në përcaktimin e numërit të punonjësve manovratorë dhe shofere, është përcaktuar duke patur parasysh volumin e punimeve që do të kryhen, si dhe sasinë dhe llojin e mjeteve që nevojiten për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Punonjësit, specialistët, inxhinierët dhe stafi i kualifikuar të kërkuar i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 në DST, duhet që nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar për t’u paraqitur, të vërtetojnë se disponojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.37 (Makinëri, Pajisje)

- g) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet, makineritë dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Nr.	Përshkrimi i Automjetit/ Makinerisë/ Pajisjes	Sasia
1.	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
2.	Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton	<i>jo më pak se 1 copë</i>
3.	Mjet për riparim linja me kosh (me krah deri 25 m)	<i>jo më pak se 1 copë</i>
4.	Autovinç	<i>jo më pak se 1 copë</i>
5.	Ekskavator me goma	<i>jo më pak se 1 copë</i>
6.	Minifadrome/Minidamper	<i>jo më pak se 1 copë</i>
7.	Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m ³ për punime në kantier	<i>jo më pak se 1 copë</i>
8.	Vibrator betoni	<i>jo më pak se 1 copë</i>
9.	Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove	<i>jo më pak se 3 copë</i>
10.	Kit vegla pune	<i>jo më pak se 10 copë</i>
11.	Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale	<i>jo më pak se 10 copë</i>
12.	Pajisje tërheqëse për kablllo me dinamometër	<i>jo më pak se 1 copë</i>
13.	Kenotron për kablllo	<i>jo më pak se 1 copë</i>
14.	Gjenerator për kantierin	<i>jo më pak se 1 copë</i>
15.	Terameter	<i>jo më pak se 1 copë</i>
16.	Vinc kulle	<i>jo më pak se 1 copë</i>
17.	Instrument per piketim (GPS)	<i>jo më pak se 1 copë</i>

- h) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtëse në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:
- Kokore – *jo më pak se 17 copë*
 - Prozhektorë ndriçimi natën – *jo më pak se 4 copë*
 - Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 5 copë*
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 10 copë*
 - Kullë ndricimi – *jo më pak se 1 copë*
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo më pak se 5 copë*
- ☐ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast**

se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

- 13- Për mjetet që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 14- Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 15- Për pajisjet në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).
- 16- Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes (*të paktën 1*).

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.9/a, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatorën e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në bazë të punimeve që do të kryhen, nisur nga preventivi komisioni ka vlerësuar se mjetet e kërkuara janë të domosdoshme për përmbushjen e kontratës si më poshtë:

- Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e shtyllave në objekt . Zëri në analizë: F.V. Shtylla të centrifuguara B/A cent.9/6 m/kN, 150/255 d1/d2 (me makineri), F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)

- Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 7 ton – është e nevojshme pasi shërben për transportimin e e kabllit ABC Zëri në analizë: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm²
- Autovinç- është i nevojshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve te demontuara. Zëri në analizë : Demontim Shtylla druri (me makineri) ,Demontim traverse te vogla me krah. etj.
- Autobetoniere me kapacitet deri në 3.5 m³ për punime në kantier – është e domosdoshme për punimet e betonit për bazamentet e shtyllave. Zëri në analizë: Struktura monolite betoni C 16/20.
- Vibrator – është e domosdoshme për ngjeshjen dhe kompaktimin e betonit për bazamentet që të mos krijohen boshllëqe. Zeri ne preventiv -Struktura monolite betoni C 16/20
- Eskavator me goma 0.25 m³ - është i nevojshëm për hapje,themele për shtylla,gropa për bazamente/për pastrim ose rrafshim terreni.Njëkohësisht shërben edhe për ngarkim+shkarkim të materialeve(zhavor,rërë,dhe).Zëri në analizë: Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV,~2.5 m, sip tabani 1.5m² , Struktura monolite betoni C 16/20, Shtrese rere etj.
- Vinç kulle – është një pajisje ndihmëse që shërben për ngritjen dhe vendosjen e percejllesi ABC dhe terminaleve .Zëri në analizë: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm², FV.Terminal TU 0.6/1kV në shtyllë për kalim nga kablli PVC në kabëll ABC(S=25÷120) mm².
- Kambaleca për mbajtjen e barabaneve të kablllove – një mjet mbajtës i domosdoshëm që mundëson shtrirjen e sigurt dhe të rregullt të kablllove nga barabani. Kjo sjell lehtësim në tërheqjen e kabllit nga barabani pa e dëmtuar atë, pasi barabani qëndron i ngritur dhe rrotullohet lirshëm mbi kambalec.
- Gjenerator për kantierin – nevojitet pasi shërben për furnizimin me energji të pajisjeve elektrike ose për testimet në terren të pajisjeve.

- Mjet për riparim linja me kosh (me krah deri 25 m)- sherben per ngritjen e punonjesve ne lartesi, per kryerjen e punimeve te preventivit .
- Kit vegla pune -nevojiten për montimin, përpunimin dhe lidhjen e kabllave e përçuesve, montimin e terminaleve dhe aksesoreve, shtrëngimin e lidhjeve mekanike dhe elektrike, si dhe për kryerjen e punimeve të ndryshme ndihmëse gjatë instalimit dhe rikonstruksionit.
- Minifadrome/Minidamper, sherbejne per kryerjen e punimeve per zerat Germim dheu per gropa shtyllash T/L, ne toke te forte kat IV, ~2.5 m, sip tabani 1.5m2
- Instrument per piketim (GPS) , sherben per piketimin e shtyllave referuar zerave te punimeve An F.V. Shtylla të centrifuguara B/A cent.9/6 m/kN,150/255 d1/d2 (me makineri), F.V. Shtylla të centrifuguara betonarme 9/6 m/kN, 220/355 d1/d2 (me makineri)
- Set karrukulla për shtrirjen dhe tërheqjen e përcjellësit për pozicione horizontale- përdoret si pajisje ndihmëse e procesit të montimit të linjës ajrore, për mbështetjen dhe drejtimin e përcjellësve gjatë tërheqjes.
- Kenotron për kabllot – është i nevojshme pasi është një pajisje e cila teston izolimin e kabllave(kontroll i cilësisë para vendosjes së tij në objekt), zeri i punimeve Kenotronim i kokave te kabllit per seksion (25 ÷ 240) mm², tension 24 kV.
- Terameter- sherben per matjen e rezistences se tokezimit, zeri AN, 4.25 Matje kontroll i Rezistences se tokezimit per nje shtylle
- Pajisje tërheqëse për kablllo me dinamometër – është e nevojshme pasi shërben për tërheqjen dhe tirimin e kabllit me vetëmbajtje ABC,që më pas fiksohet në tirantues dhe në këtë mënyrë nuk dëmtohet izolimi i tij.Zëri i analizës: F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x70mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x50mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x35mm²,F.V. Kabëll ajror ABC me vetë-mbajtje në të gjithë kabllin, izolim XLPE Al 0.6-1kV, 4x25mm²,

2.3.38 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 1 (një) kantier për prodhimin e betonit në pronësi ose me qera ose me kontratë furnizimi (*Kontrata Nateriale e Qerasë/Furnizimit duhet të ketë kohëzgjatje për gjithë periudhën e realizimit të punimeve objekt kontrate*), ku për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet:

- Dokumentacioni që vërteton pronësinë (*Çertifikatë, Plan-Vendosje & Kartelë e pasurisë*) dhe kontratën noteriale të qerasë/ furnizimit *në rast se kantieri është me qera ose kontratë furnizimi.*
- Leje Mjedisi nga QKL, (*përkatëse*) *në përputhje me ligjin.*

Në rastin kur Kantier për prodhimin e betonit nuk janë në pronësi apo me qera nga OE, por me kontratë furnizimi shmanget nga paraqitja e dokumentacionit me sipër.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik1” (i ndryshuar) në të cilin, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/d të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:... d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Gjithashtu, referuar punimeve objekt prokurimi, njësia e prokurimit vlerëson se, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë disponimin e 1 (një) kantieri për prodhimin e betonit në pronësi, ose me qera ose me kontratë furnizimi, pasi kjo i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët janë të aftë të sigurojnë sasinë e nevojshme të materialeve që do të përdoren në investim, si dhe sigurinë e cilësinë të mallrave/ produkteve, duke qënë se kemi të bëjmë me produkt i cili duhet të prodhohet nga prodhues të licencuar etj., kërkesë kjo në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi, ku në lidhje me përmbushjen e këtij kushti, njësia e prokurimit ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit ligjor në mbështetje të ligjit nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i

ndryshuar), ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”. Dokumentacioni për përmbushjen e këtij kushti, kërkohet me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik pjesëmarrës disponon vetë (pronësi/ qera) kantierin, ose ka nënshkruar një kontratë furnizimi me një subjekt i cili disponon vërtet kantierin për prodhimin e betonit, pasi ky është dokumentacioni ligjor që vërteton ekzistencën e kantierit, në rast të kundërt nuk do vërtetohej dot nëse kontrata e furnizimit është lidhur me një subjekt i cili e disponon këtë kantier. Paraqitja e dokumentacionit përveç se nuk përbën kosto për operatorin ekonomik pjesëmarrës, por duhet të jetë pjesë dhe e kontratës që nënshkruhet, me qëllim vërtetimin se pala furnizuese është prodhuese e këtij malli.

2.3.1 Afati i kryerjes së punimeve:

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Argumentimi:

Në nenin **15 pika 3/a** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash parashikohet se: **“a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”**

Njësia e prokurimit referuar të dhënave teknike të projektit, ku parashikohet dhe afati i kryerjes së punimeve bazuar në grafikun e punimeve, vendosi miratimin e afatit të punimeve prej:

3 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit per Loti 1: Kalimi i 4 fiderave të Gurit të Kuq nga 6 kV në 10 kV, Pogradec

3 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit per Loti 2: Rrjet TU me kabell ABC Fshati Dishnicë, Fideri 21, Nënstacioni Korçë

3 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit per Loti 3: Rrjet TU me kabell ABC Fshati Dvoran, fideri Fshat, Nënstacioni Gjanc Korçë

3 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit per Loti 4: Rrjet TU me kabell ABC fshati Porodina, fideri 17, Nënstacioni Korçë

- vlerësuar si afat i mjaftueshëm për realizimin e kryerjes së punimeve objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike standarte dërguar nga Dega Teknike/ Drejtoria Rajonale e OSSH, Korce, për punimet objekt prokurimi, duke qënë se specifikimet teknike të dërguara,

plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020“Për Prokurimin publik1” (i ndryshuar), dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

Njesia e Prokurimit